

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

KOORDINATORI KOMBËTAR KUNDËR KORRUPSIONIT

Roli i Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit

Ministri i Drejtësisë, në rolin e Koordinatorit Kombëtar Kundër Korrupsionit bashkërendon punën për hartimin e politikave dhe përgatitjen e akteve ligjore dhe nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit.

Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit është përgjegjës për kryerjen e verifikimit (hetimit administrativ) të denoncimeve/ankesave për praktika abuzive, korruptive apo arbitrare për zbatimin e ligjshmërisë, si dhe identifikimi i punonjësive të institucioneve, pjesë të Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion, të cilët, me veprime apo mosveprime, kanë kryer shkelje të akteve ligjore/nënligjore në fuqi, si dhe njëkohësisht zhvillimi i projekteve dhe i programeve në fushën kundër korrupsionit, planifikimi, koordinimi dhe përcaktimi i instrumenteve të domosdoshme për implementimin e politikave të fushës kundër korrupsionit.

Buletini elektronik është një mjet i gjerë komunikimi që synon të informojë nëpërmjet pasqyrit të një përmbledhjeje të aktiviteteve kryesore të zhvilluara nga Ministria e Drejtësisë në fushën antikorrupsion, mbi baza mujore.

Aktivitetet përgjatë muajit Janar, 2024

Znj. Adea Pirdeni, emërohet Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin

11.01.2024: Kabineti qeveritar i vendit u plotësua me një portofol të ri, Ministër Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Ministër Shteti znj. Adea Pirdeni, ish Zëvendësministre e Drejtësisë, që prej vitit 2020, ka marrë detyrën e ministrit pas betimit të bërë pranë Presidentit të Republikës, Sh.K.Z. Bajram Begaj. Ministri i Shtetit znj. Pirdeni është propozuar në këtë detyrë të lartë ekzekutive nga Kryeministri, z.Edi Rama dhe mori votë-besimin në Kuvend me 73 vota pro. “Është e udhës që politikant antikorrupsion të qeverisë të harmonizohen më mirë mes institucioneve të ekzekutivit, me ekzigjencat e procesit sfidues të negociatave me BE për të gjitha institucionet e vendit, si edhe me vetë shoqërinë civile e sipërmarrjen”- shkruajti Kryeministri Rama në publikimin e tij të emërimit të ministres. Ministri i Shtetit znj. Adea Pirdeni do të mbajë gjithashtu rolin e Koordinatorit të ri Kombëtar Kundër Korrupsionit, do të drejtojë hartimin e politikave kombëtare dhe përgatitjen e akteve ligjore e nënligjore për parandalimin dhe luftën kundër korrupsionit. Ministri i Shtetit është gjithashtu drejtues i politikave, për menaxhimin dhe energjizimin e burimeve njerëzore të administratës publike, ndërtimin e institucioneve të administratës shtetërore dhe trajnimin e të punësuarve të administratës publike. Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin është caktuar gjithashtu përgjegjës për përbushjen e parimeve të qeverisjes së mirë dhe partneritetit për qeverisje të hapur. Emërimi i një Ministri Shteti për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin u mirëprit nga përfaqësitë e organizatave shtetërore të huaja në Tiranë duke e vlerësuar kryqëzimin e këtyre dy fushave të qeverisjes me rëndësi dhe pritshmëri për vendin në fazën në pararendje të integritetit të vendit në Bashkimin Evropian.



Viti 2023; Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion procedon 177 masa disiplinore, 175 rekomandime dhe 16 kallëzime penale

23-24.01.2023: Drejtorja e Përgjithshme e Antikorrupsionit zhvilloi analizën vjetore si pjesë e strukturës teknike të Ministrisë së Drejtësisë, për vitin e plotë të punës, 2023. Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion, ka pasur kryesisht në fokus të saj aktivitet të shtuar të rasteve të verifikimit dhe hetimit administrativ të praktikave abuzive në administratën publike, së bashku me mekanizmin e Rrjetit të Koordinatorëve Antikorrupsion (në vijim Rrjeti). Për vitin 2023, janë depozituar 892 ankesa, mes të cilave janë përfunduar 533 prej tyre dhe 359 ankesa mbeten ende në proces shqyrtimi nga specialistët e drejtorisë. Për vitin 2023 janë propozuar 177 masa disiplinore, 175 rekomandime si dhe janë dorëzuar pranë organit të prokurorisë 16 kallëzime penale për 42 persona. Është përgatitur një dokument draft - Analizë dhe Vlerësim Risku për 24 institucione, dhe mbetet në proces konsultimi pranë koordinatorëve të institucioneve përkatëse, me qëllim marrjen e komenteve dhe sugjerimeve në kuadër të përmirësimit të tij dhe përfshirjes së institucioneve të tjera pjesë të Rrjetit. Gjatë vitit 2023, Koordinatori Kombëtar Kundër Korrupsionit ka miratuar Plane Kontrolli për 17 institucione, të cilat përmbajnë veprimtaritë më të riskuara për abuzivitet dhe korrupsion e për të konkretizuar fokusin e hetimeve të nisura kryesisht. Edhe për vitin 2023, problematikat e rasteve të korrupsionit vijnë në mbeten kryesisht të përqendruara në shërbimet e organeve të administratës për publikun.

Denonconi raste dhe praktika abuzive, në adresën: koordinatoriak@drejtesia.gov.al

Ministria e Drejtësisë miraton Plan të ri Integritetit, 2024-2027

01.01.2024: Ministria e Drejtësisë ka prej 1 janarit 2024 në zbatim një instrument të ri integritetit. Me urdhër të Ministrit të Drejtësisë, nr.705, datë 18.12.2023, u miratua Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, 2024-2027, i dyti instrument që identifikon dhe adreson ndërhyrjet institucionale për të garantuar një aktivitet të rregullt, llogaridhënie dhe efikasitet në përdorimin e burimeve njerëzore, financiare dhe të komunikimit. Plani i ri i Integritetit, 2024-2027, u hartua gjatë periudhës shtator-dhjetor 2023, në përputhje me Metodologjinë e Vlerësimit të Riskut të Integritetit për Qeverisjen Qendore. Për këtë qëllim, u krye analiza e kuadrit ligjor, rregullator të brendshëm dhe të vlerësimit të intensitetit të risqeve prezentë në institucion. Plani i Veprimit si pjesë e integrale e Planit të Integritetit, përmban masa të reja kontrolli dhe përmirëson formulimin dhe vijueshmërinë e atyre ekzistuese. Janë në total 31 masa për 13 fusha të përgjegjësisë teknike të Ministrisë së Drejtësisë, për 3 objektivë specifikë: (I) Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit, (II) Përmirësim i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikimi i shtuar dhe kapacitete të trajnuara dhe (III) Transparencë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e interesit dhe publikun e gjerë. Risi në këtë dokument është përfshirja e masave për rritjen e ndërgjegjësisë dhe informimit të personave me funksione politike, këshilltarët politikë. Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë do të monitorohet për zbatimin e tij, në fund të 6-mujorit të parë 2024 dhe në përfundim të vitit 2024.

Plani i Integritetit të Ministrisë së Drejtësisë, 2024-2027, mund të aksesohet në këtë link: <https://www.drejtesia.gov.al/instrumente-antikorrupsioni/>

PLANI I INTEGRITETIT

PËR MINISTRINË E DREJTËSISË
2024-2027

Mirator i caktuar: Nr. 705/18.12.2023/Ministria e Drejtësisë

Shprehim i fortë të mirënjohjes dhe respektit ndaj të gjithë bashkëpunuesve të drejtësisë dhe të integritetit.

Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsionit

Objektivi	Masa	Numri i masave	Numri i personave
1. Forcimi i kuadrit rregullator të integritetit dhe instrumenteve të luftës kundër korrupsionit	1.1. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore	10	10
	1.2. Përmirësimi i kualifikimit të personave me funksione politike	10	10
	1.3. Përmirësimi i kapaciteteve të personave me funksione politike	10	10
2. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore, kualifikimi i shtuar dhe kapacitete të trajnuara	2.1. Përmirësimi i kualifikimit të personave me funksione politike	10	10
	2.2. Përmirësimi i kapaciteteve të personave me funksione politike	10	10
	2.3. Përmirësimi i menaxhimit të burimeve njerëzore	10	10
3. Transparencë e shtuar dhe e plotë institucionale, partneritet me grupet e interesit dhe publikun e gjerë	3.1. Përmirësimi i transparencës së shtuar dhe e plotë institucionale	10	10
	3.2. Përmirësimi i partneritetit me grupet e interesit dhe publikun e gjerë	10	10
	3.3. Përmirësimi i transparencës së shtuar dhe e plotë institucionale	10	10

Masat kundër korrupsionit pjesë e Planit Kombëtar të Reformave dhe të Rritjes në Bashkimin Evropian

16.01.2024: Ministria e Drejtësisë ka një rol të konsiderueshëm në hartimin e angazhimeve qeveritare e shtetërore të Planit Kombëtar të Reformave dhe të Rritjes. Reformat e propozuara në funksion të agjendës së rritjes nga Qeveria Shqiptare dhe ato të propozuara nga Komisioni Evropian janë tashmë të organizuara bashkë në një dokument të unifikuar ku sektori i drejtësisë, sektori i luftës kundër korrupsionit dhe paketa e të drejtave dhe lirive të njeriut janë nën mentorimin dhe kujdesin për zbatim të Ministrisë së Drejtësisë. Në vijim të procesit të miratimit të Udhërrëfyesit “Shteti i së Drejtës”, me vendim të Këshillit të Ministrave në 13 dhjetor 2023, i cili përbën edhe dokumentin bazë të integritetit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian po hartohet agjenda e reformave për zhvillim dhe integritet. Lufta kundër korrupsionit do të orientohet në kuadër të zhvillimit themelor të instrumentave parandalues, ngritje së një kuadri të harmonizuar historik të të dhënave statistikore si edhe progresit të të dhënave për hetimin dhe ndëshkimin e krimit të korrupsionit në radhët e zyrtarëve të lartë shtetërore. Miratimi dhe zbatimi i sigurtë i dokumentit kombëtar të planifikimit strategjik antikorrupsion (Strategjia Ndërsektoriale kundër Korrupsionit, 2024-2030), nisma dhe zhvillimi i mekanizmave të vlerësimit të riskut të korrupsionit në sektorët e identifikuar si vulnerabël për korrupsion (arsimi-shëndetësia-taksa e tatime-pronat-prokurimi publik), ndërkombëtarizimi i arritjeve në luftën kundër korrupsionit si edhe ndërgjegjësimi dhe edukimi i shtuar kundër korrupsionit janë pjesë esenciale e këtij dokumenti. Programimi i tyre u bë pjesë e temës së bisedës së takimit me grupit negociator të qeverisë shqiptare, të kryesuar nga Ministri i Shtetit për Integritet dhe Kryenegociator dhe grupit të ekspertizës së Komisionit Evropian. Takimet vijnë në dakordësimin e dokumentit dhe me miratimin e vullnetit politikë.



Bulevardi Zog I-rë, Tiranë



<http://www.drejtesia.gov.al>




infoak@drejtesia.gov.al



CPI 2023: Shqipëria merr 37 pikë dhe renditet në vendin e 98 nga 180 vende

30.01.2024: Organizata *Transparency International* publikoi Indeks të Perceptimit të Korrupsionit (CPI 2023) dhe Shqipëria edhe për këtë herë fitoi pikë dhe vend në renditjen totale të vendeve. Shqipëria u vlerësua me një pikë më shumë se vitin e mëparshëm, me 37 pikë (36 viti i kaluar) dhe radhitur në vendin e 98-të mes 180 vendeve (nga 101 në vitin e kaluar). CPI 2023 e orientoi vlerësimin për vendet mbështetur kryesisht tek rezultatet e sistemit të drejtësisë dhe nivelin e ndëshkimit të zyrtarëve të lartë. “Shqipëria po përmirëson të dhënat e saj me anë të hetimit dhe ndjekjes penale të korrupsionit të nivelit të lartë, por përparimi më i madh ndikohet nga forcimi i legjislacionit të drejtësisë penale dhe sigurimi i një mbikëqyrje efektive të ekzekutivit. Vendimi për krijimin e një ministrie të re të ngarkuar me përgjegjësinë kundër korrupsionit vjen me pritshmëritë për mekanizma efektivë të integritetit. Megjithatë, kjo nuk mund të arrihet përsa kohë parlamenti nuk ka kontroll më të fortë, e organizatat e shoqërisë civile dhe mediat mund të kryejnë rolin e tyre mbikëqyrës pa u penguar nga autoritetet” – komenton Indeksi. *Transparency International* përdor një sistem llogaritjeje të indeksit nga 0 në 100 pikë, ku 0 pikë i referohet nivelit më të lartë të korrupsionit dhe 100 pikë mungesës së korrupsionit në vend.



Më shumë informacion mund të gjeni në: <https://www.transparency.org/en/cpi/2023/index/alb>

Bashkëpunimi gjyqësor ndërkombëtar si mjet i luftës kundër korrupsionit bashkon ekspertë ndërkombëtare antikorrupsion, anëtarë të Rrjetit Globe

30.01.2024: Drejtorja e Përgjithshme Antikorrupsion mori pjesë në takimin *online* të organizuar nga Rrjeti Global i Autoriteteve Ligjzbatuese Antikorrupsion – GlobE. Takimi me titull: *Tejkalimi i dallimeve ligjore ndërmjet juridiksioneve në bashkëpunimin ndërkombëtar*, ofroi për të gjithë pjesëmarrësit shqyrtimin e tejkalimit të dallimeve ligjore midis juridiksioneve në bashkëpunimin ndërkombëtar, duke përdorur njohuri të shtuara praktike nga Brazili, duke qenë se mikpritës ishin autoritetet e këtij vendi. Takimi kishte në fokus shqyrtimin e strategjive dhe hapave praktikë që lidhen me tejkalimin e dallimeve ligjore midis juridiksioneve.

Folësit kryesorë ofruan rekomandime dhe sugjerime të rëndësishme për përmirësimin e procedurave të bashkëpunimit ndërkombëtar siç përmenden forcimi i bashkëpunimit joformal, reflektimi dhe përmirësimi konstant dhe mësimet e marra nga çështjet e mëparshme si raste precedente. Diskutimi rreth parakushteve për përdorimin e bashkëpunimit ndërkombëtar, përgatitjes së dokumenteve, si dhe arritjes së bashkëpunimit me homologët e huaj është thelbësor për efikasitetin e procesit të drejtësisë ndërkombëtare, u evidentua në takim. Gjithashtu, u vlerësua procedura specifike për bashkëpunimin ndërkombëtar duke përfshirë natyrën e saj, procesin e rregullt në praktikë, të drejtat e të pandehurve, rregullat e provës, dhe sanksionet. Për të përmirësuar efikasitetin e bashkëpunimit, një prej rekomandimeve të takimit ishte përgatitja e prezantimeve dhe kujdesi i veçantë ndaj përkthimit të dokumenteve. Shqipëria është anëtare Rrjetit GlobE me përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, Prokurorisë së Përgjithshme dhe Prokurorisë së Posaçme - SPAK. Takime të tilla janë një eksperiencë e shtuar për stafin dhe praktikuesit e së drejtës në institucionet tona.



Bulevardi Zog I-rë", Tiranë



<http://www.drejtesia.gov.al>



infoak@drejtesia.gov.al

